



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës **KSC-BC-2020-06**

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

 Gjykatës Nikola Giju

Administratore: **Dr. Fidelma Donlon**

Data: **3 shkurt 2021**

Gjuha: **Anglishte**

Klasifikimi: **Publik**

Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe Paraqitjen e Parashtrimeve

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën (“Aktakuza e Konfirmuar”) kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (përkatësisht “z. Thaçi”, “z. Veseli”, “z. Selimi” dhe “z. Krasniqi”, dhe bashkërisht “Mbrojtja”).²

2. Më 30 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar,³ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴

3. Më 4 dhe 5 nëntor 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁵ z. Krasniqi, z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi u arrestuan⁶ dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁷

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020, publike.

⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(c)-(d).

⁵ KSC-BC-2020-06, F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 26 tetor 2020, publik, me shtojcat 1-8, publike. Versionet e korrigjuara të Shtojcave 7 dhe 8 u dorëzuan më 28 tetor 2020, shih përkatësisht F00027/A07/COR/RED dhe F00027/A08/COR/RED.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00044, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Jakup Krasniqit, sipas Rregullës 55(4)*, 4 nëntor 2020, nëntor; F00049, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Rexhep Selimit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, nëntor; F00050, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00051, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00048, Administratorja, *Njoftim i Pranimin të Jakup Krasniqit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 4 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike; F00053,

4. Midis 9 dhe 11 nëntorit 2020, u mbajtën paraqitjet e para për z. Krasniqi,⁸ z. Thaçi,⁹ z. Veseli¹⁰ dhe z. Selimi.¹¹
5. Më 18 nëntor 2020, në bazë të urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për caktimin e datës,¹² u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes.¹³
6. Më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të ("Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave"), në të cilin përcaktoi parimet për nxjerrjen e provave ndërmjet palëve, kalendarin e nxjerrjes së provave që vazhdon deri në korrik 2021, si dhe sistemin e redaktimit për t'u zbatuar në këtë çështje gjyqësore.¹⁴
7. Më 10 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin e parë për masa mbrojtëse në këtë çështje gjyqësore, në të cilin shtyu vendimin mbi masat mbrojtëse për disa dëshmitarë të caktuar ("Vendimi mbi Masat Mbrojtëse").¹⁵

Administratorja, Njoftim i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Emërimit të Mbrojtësit, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00054, Administratorja, Njoftimi i Pranimit të Kadri Veselit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Emërimit të Mbrojtësit, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F00055, Administratorja, Njoftimi i Pranimit të Rexhep Selimit në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Emërimit të Mbrojtësit, 5 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 5 nëntor 2020, publik, para. 21(a). *Shih gjithashtu* Transkriptin, 9 nëntor 2020, publik.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih gjithashtu* Transkriptin, 9 nëntor 2020, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih gjithashtu* Transkriptin, 10 nëntor 2020, publik.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00061, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a). *Shih gjithashtu* Transkriptin, 11 nëntor 2020, publik.

¹² KSC-BC-2020-06, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe Paraqitjen e Parashtrimeve*, 11 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike.

¹³ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 18 nëntor 2020, publik.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të*, 23 nëntor 2020, publik, para. 99.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00133/COR/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Parë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse*, 10 dhjetor 2020, konfidencial, para. 132(c), (f), (j), (n).

8. Më 17 dhjetor 2020, në bazë të urdhrorit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për caktimin e datës,¹⁶ u mbajt konferenca e dytë mbi ecurinë e çështjes ("Konferenca e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes").¹⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Sipas rregullës 96(1) të Rregullores, pas konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencat vijuese mbi ecurinë e çështjes, në qoftë se e gjykon të nevojshme për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejta për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

10. Sipas nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në posedim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizimet rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e masave mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Sipas rregullës 102 (3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.

11. Sipas rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar të paraqesë: (i) dosjen paraprake, ku përfshihet çdo pranim në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes dhe një listë e pikave të pakontestuar: (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë; dhe (iii) listën e provave

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00130, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe Paraqitjen e Parashtrimeve*, 8 dhjetor 2020, publik, para. 19(a).

¹⁷ KSC-BC-2020-06, Transkripti i seancës, 17 dhjetor 2020, publik.

materiale që synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdo që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e tyre.

12. Sipas rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të caktuar të dorëzojë dosjen paraprake. Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në për synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore.

13. Sipas rregullës 96 (2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që merret pas këshillimit me mbrojtësin e vet, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me mbrojtësin të pranishëm ose që merr pjesë nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës i paraqitet drejtpërdrejt Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës të Administratores për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR), paraprakisht e në kohë të mjaftueshme, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, ku përfshihet edhe informimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁸

¹⁸ *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizimin e Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizimin e Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.*

III. DISKUTIM

14. Pasi ka shqyrtuar preferencat për datat të shprehura nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake cakton që konferenca e tretë mbi ecurinë e kësaj çështjeje gjyqësore të mbahet të enjten, më 11 shkurt 2021, në orën 11:00.

15. Gjatës seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve përditësime, nëse kanë, për pikat ende të pazgjidhura nga konferenca e dytë mbi ecurinë e çështjes, si dhe për parashtrimet me shkrim dhe me gojë që kanë bërë lidhur me ato pika. Konkretisht dhe përveç kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime për pikat vijuese, sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialeve:

- a. Çfarë përparimi është bërë në nxjerrjen e materialit provues nga ZPS-ja, në veçanti:
 - i. lidhur me materialin e rregullës 102(1)(a), nëse janë përmbushur detyrimet e nxjerrjes së këtij materiali; dhe
 - ii. lidhur me materialin e rregullës 102(1)(b), edhe sa nga ky material mbetet për t'u nxjerrë dhe nëse ZPS-ja parashikon të dorëzojë kërkesa për masa mbrojtëse për materialin e rregullës 102(1)(b) deri më 5 mars 2021;
- b. Nëse ka ende prova shfajësuese në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së që duhet t'i nxirren Mbrojtjes, sipas rregullës 103 të Rregullores, dhe nëse për këtë material, para nxjerrjes së tij, kërkohet vendim gjyqësor për masa mbrojtëse; dhe
- c. Nëse palët po përballen ose parashikojnë të përballen me ndonjë vështirësi sa i takon procesit të nxjerrjes së provave, veçanërisht në lidhje me materialin e rregullës 107.

(2) Përkthimi i përmbledhjes sipas rregullës 86(3)(b) (F00136/A01):

- d. Nëse Zyra Administrative mund të japë një vlerësim se kur do të përfundojë përkthimi i përmbledhjes sipas rregullës 86(3)(b); dhe
- e. Nëse përkthimet mund të dorëzohen në mënyrë progresive, me të përfunduar të përkthimit të një pjese të përmbledhjes.

(3) Tabela sipas rregullës 109(c):

- f. Nëse është bërë ndonjë përparim i mëtejshëm, ndër të tjera, për të arritur marrëveshje në lidhje me tabelën sipas rregullës 109(c) sa i përket:
 - i. formatit të tabelës;
 - ii. nivelit të kategorizimit të materialit të nxjerrë, ku ndër të tjera përfshihet edhe mundësia për ta bërë kolonën “referencat specifike” jo të detyrueshme për palën që nxjerr informacionin;
 - iii. me cilin material të nxjerrë lidhet tabela, në veçanti nëse lidhet vetëm me materialin e rregullës 102(1)(b) apo edhe me materiale të tjera;
 - iv. afatit kur do të paraqitet tabela, për shembull, 15 ditë pas dorëzimit të çdo dosjeje paraprake; si edhe,
 - v. kategorizimit të hapësirave të meta të dhënave në sistemin elektronik *Legal WorkFlow* në lidhje me çdo material të nxjerrë, në veçanti nëse këto kategori duhet të pasqyrojnë kategoritë në rregullën 109(c) të Rregullores, apo nëse duhet të përfshihen edhe nënkategori shtesë; dhe
- g. Çfarë ndikimi do të kishte secili prej propozimeve të Mbrojtjes në lidhje me tabelën sipas rregullës 109(c), në afatet e ZPS-së për nxjerrjen e materialit dhe

në vlerësimin e ZPS-së se kur do të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen paraprake të saj.

(4) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e mëtejshëm:

- h. Nëse ZPS-ja mund të japë përditësim të mëtejshëm për datën e parashikuar të përfundimit të hapave hetimorë të papërfunduar; dhe
- i. Nëse është ende i vlefshëm parashikimi i ZPS-së (korrik 2021) për dorëzimin e dosjes paraprake dhe materialit në lidhje me të sipas rregullës 95(4)(a)-(c) të Rregullores, duke mbajtur parasysh Vendimin mbi Masat Mbrojtëse dhe kalendarin e nxjerrjes së materialit të përcaktuar në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave.

(5) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm:

- j. Nëse Mbrojtja, bazuar në parashikimet e ZPS-së dhe procesin në vijimësi të nxjerrjes së provave (i planifikuar të vazhdojë deri në korrik 2021), mund të japë më shumë informacion për ecurinë e hetimeve të saj;
- k. Po ashtu, nëse Mbrojtja mund të japë më shumë informacion lidhur me synimin për të bërë kërkesa për mundësi hetimore të vetme sipas rregullës 99(1) të Rregullores; dhe
- l. Nëse Mbrojtja mund të japë më shumë informacion lidhur me synimin për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale sipas rregullës 95(5) të Rregullores, si dhe çdo nxjerrje shoqëruese materiali, sipas rregullës 104(1) dhe (2) të Rregullores.

(6) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen:

- m. Nëse palët kanë hyrë në diskutime në lidhje me mundësinë për të paraqitur pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen, sipas rregullave 95 (3) dhe 156 të Rregullores; dhe
- n. Kur presin palët të jenë në gjendje të identifikojnë një listë pikash për të cilat nuk pajtohen dhe një listë pikash për të cilat pajtohen?

16. Së fundi, palëve do t'u kërkohet të japin mendimet e tyre lidhur me datën për konferencën e ardhshme mbi ecurinë e kësaj çështjeje gjyqësore.

17. Palët ftohen të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, lidhur me cilëndo nga pikat e mësipërme. Në rast se palët dëshirojnë të ngrenë ndonjë pikë tjetër në konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes, e cila nuk është përfshirë në këtë urdhër, atëherë ftohen t'i përfshijnë ato pika në parashtrimet e tyre me shkrim. ZPS-ja ftohet të dorëzojë parashtrimet deri të hënën, 8 shkurt 2021, në orën 16:00, ndërsa Mbrojtja ftohet të dorëzojë parashtrimet e saj deri të mërkurën, 10 shkurt 2021, në orën 12:00.

18. Zyrës Administrative i kërkohet të paraqesë parashtrimet me shkrim lidhur me përkthimin e përmbledhjes sipas rregullës 86(3)(b) përmendur më lart, deri të hënën, 8 shkurt 2021, në orën 16:00.

IV. VENDIM

19. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të mbajë konferencë mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, **të enjten, 11 shkurt 2021, në orën 11:00;**
- b. I **KËRKON** ZPS-së të paraqesë parashtrime me shkrim, nëse dëshiron, deri **të hënën, 8 shkurt 2021, në orën 16:00**, sikurse përcaktohet në paragrafin 17;

- c. I **KËRKON** Mbrojtjes të paraqesë parashtrime me shkrim, nëse dëshiron, deri të **mërkurën, 10 shkurt 2021, në orën 12:00**, sikurse përcaktohet në paragrafin 17;
- d. I **KËRKON** Zyrës Administrative të paraqesë parashtrime me shkrim në lidhje me paragrafin 15(2), deri të **hënën, 8 shkurt 2021, në orën 16:00**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 3 shkurt 2021
Në Hagë, Holandë.